



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 05.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.01.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **HIDRO BAU SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK**” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **HIDRO BAU SH.P.K.** e datës 31.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK**” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontrate, të datës 08.01.2024 të publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Korrigjohen** kriteret e tenderit me sqarime shtesë;
- III. Autoriteti Kontraktues, pas njoftimit per korrigjim do te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **HIDRO BAU SH.P.K.**, me datë 31.01.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK**” me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1, Autoriteti Kontraktues, me datë 05.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Nuk ka specifikuar ndonje dispozite te shkelur

Pretendimet ankimore

Ne si operator ekonomik kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues një sqarim ne lidhje me kushtet ne Dosje te Tenderit.

Sipas kushteve ne FTD Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit).

Ne kërkojmë nga ju qe te na e sqaroni se: A lejohet qe mbështetja bankare te behet ne 2 ose me shume institucione bankare për arsye nëse biznesi ka te 1 ose me shume llogari bankare aktive?

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Përmbajtja e kërkeses per rishqyrtim eshte shume e manget, kjo me shume eshte e karakterit te pyetjeve sqaruese te cilat kane mundur te sqarohen me pyetje shitesë pa pasur nevojë te beni kerkese per rishqyrtim.

Pajtohem me pretendimin ankimor, lejohet mbështetja bankare te behet nga 2 ose me shumë institucione bankare.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. HIDRO BAU SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit